



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Mbledhja nr. 76

Prishtinë, më 10.05.2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S- II

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Ahmet Isufi, Rexhep Selmi, Goran Marinković, Fatmir Xhelili, Anton Quni, Vjollca Krasniqi, Ganimete Musliu, Rasim Demiri dhe Danush Ademi.

Përfaqësuesit nga Inspektorati Policor i Kosovës: Fitim Shishani, kryeshef i IPK-së; Arben Vrajolli, Departamenti i Inspektimeve; Valbona Osmani, Departamenti i Informacionit dhe Ankesave; Arsim Telaku, drejtor i Administratës; Arbër Beka, Departamenti i Informacionit dhe Ankesave.

Përfaqësuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme: Shpend Maxhuni, drejtor i Përgjithshëm i Policisë; Enver Rustemi, këshilltar i ministrit të Punëve të Brendshme.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hoxha, këshilltar nga OSBE-ja; Dhurata Kryeziu, OSBE; Visar Rushiti, GAP; Florian Qehaja-QKSS; Sanije Berisha-OSBE; Faton Hamiti-EULEX; Drita Perizic-ICITAP; Arbër Gorani-ICITAP; Apollon Hoxha-OSBE.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku, Haxhi Xhemajli, Zarife Aliu dhe Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi: Ahmet Isufi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Dëgjim publik rreth mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryetari i Komisionit- Hapi takimin me rastin e dëgjimit publik, duke shtuar se obligimi kushtetues që ka Komisioni, që krahas hartimit, përpunimit të projektligjeve, është edhe monitorimi i zbatimit të ligjeve, duke parë kështu më afër punën e agjencive dhe identifikimin e sfidave në institucionet që mbikëqyrë.

Fjalën ia dha z. Rexhep Selimi, kryesues i grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të IPK-së.

Rexhep Selimi- Komisioni ka themeluar grupin punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të IPK-së, me këtë përbërje: z. Fatmir Xhelili, z. Anton Quni dhe z. Goran Marinkoviq.

Grupi punues ka realizuar disa aktivitete në kuadër të mbikëqyrjes së Ligjit të IPK-së. janë realizuar takime të grupit punues dhe vizita në institucione të tjera, siç janë: IPK-ja, Policia e Kosovës, në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Prokurorinë Komunale.

Dëgjimi publik do t'i kontribuonte përmbylljes së këtij procesi, varësisht nga roli që mund të kenë grupet e caktuara dhe që mund të preken nga ky ligj. Puna e grupit punues ka rezultuar me të gjetura të cilat do të përfshihen në raportin përfundimtar, për këtë qëllim pres kontributin e pjesëmarrësve në vazhdim.

Fatmir Xhelili- Duke marrë parasysh që ligji i ri për IPK-në i jep të drejtën e hetimeve IPK-së, kuptohet që është e nevojshme një periudhë kohore për t'u përshtatur me ligjin e ri, për përgatitjen e kuadrove për zbatimin ligjit. Indikatorët që merren parasysh për vlerësimin e zbatimit të ligjeve janë gjithnjë të vështira, ndërsa në rastin e Ligjit të IPK-së, duhet të kemi në konsideratë se a do të merren parasysh indikatorët dhe parametrat kuantitativë apo kualitativë për zbatimin e tij.

Pyetje për drejtorin e Përgjithshëm të Policisë, z. Shpend Maxhuni:

A keni hetuar rritjen e kualitetit të punës së policisë, si në drejtim të disiplinës, ashtu edhe në drejtimin e kualitetit të punës së policisë, duke marrë parasysh rezultatet e punës së IPK-së, a ka nevojë që këta parametra të shikohen edhe më tej dhe se ndoshta është herët për të pasur një perceptim të tillë dhe të drejtë?

A janë në kundërshtim hetimet që zhvillohen për pjesëtarët civilë, që janë të involvuar së bashku me zyrtarët policorë në raste të tilla, dhe kjo ndarje e detyrës, a është duke shkuar në mënyrë të duhur dhe të drejtë dhe a është puna e IPK-së kualitative te personat civilë, që janë të involvuar me zyrtarët policorë në vepra penale?

Shpend Maxhuni, drejtor i Përgjithshëm i Policisë- Policia e Kosovës e konsideron IPK-në si një aset mbështetës në identifikimin e vështirësive për realizimin e objektivave, me qëllim të avancimit të punës në aspektin profesional.

Raportet të cilat realizohen nga ana e IPK-së, dhe të cilat i dorëzohen menaxhmentit të Policisë së Kosovës, për të trajtuar problematika që hetohen nga Inspektorati Policor, padyshim që e ndihmojnë policinë dhe se kjo ndihmë shpresoj se do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Policia e Kosovës, si institucion i ri, vërehet një trend i avancimit të përgjithshëm të punës së Policisë së Kosovës, por duke qenë edhe vetëkritikë. Ne kemi komunikim në bazë ditore me Inspektoratin Policor, si në qasjen e informimit për vështirësitë, për çështje që duhet trajtuar nga ana e tyre, por edhe qasjen e marrjes së informacioneve kthyesë kurdoherë që këta vijnë deri te një informacion, kurdoherë që këta trajtojnë nga pozicioni *ex-officio* në raport me Policinë e Kosovës.

E them me përgjegjësi, që menaxhmenti i policisë është i përkushtuar që me kohë të marrë për bazë të gjitha rekomandimet që dalin nga Inspektorati Policor dhe si drejtor i kam kthyer të gjitha përgjigjet në raport me të gjitha inspektimet, të cilat janë raportuar nga IPK-ja.

Duke iu referuar pyetjes së z. Xhelili, si drejtor i përgjithshëm kam vërejtur se kemi përmirësime, sado modeste që mund të jenë, lidhur me inspektimet që janë kryer në fusha të caktuara, por edhe me inspektimet që në forma të caktuara, nuk janë realizuar deri më tash.

Ndërsa në përgjigje të pyetjes së dytë të bërë nga z. Xhelili, në fillim ka pasur vështirësi në raport të dykuptimësisë së hetimeve për stafin civil, të punësuar në Policinë e Kosovës, por kjo vështirësi me kalimin e kohës është tejkaluar dhe se nuk kemi vështirësi apo paqartësi në raport me përgjegjësit, kur dyshohet se ata janë të përfshirë në aktivitete të dyshimta.

Anton Quni- Nga takimi i kaluar me përfaqësuesit e IPK-së, kam qenë i interesuar në lidhje me stimulimin, por edhe ndëshkimin e zyrtarëve të IPK-së. Për këtë çështje, e kemi veçuar një rast, për të cilin kemi marrë shpjegime nga ana e zyrtarëve të IPK-së, por do të ishte plotësuese nëse do të kishim shpjegime shtesë nga kryeshefi.

Një pjesëtarë i IPK-së, i cili ka qenë i përfshirë në kontrollin e protestave që janë realizuar nga Lëvizja Vetëvendosje dhe ky pjesëtar ka qenë i përfshirë, duke ndihmuar një zyrtar policor.

Nga takimet e mëhershme, përgjigjja nga z. Fitim Shishani, kryeshef i IPK-së, ka qenë se involvimi i këtij zyrtari ka qenë i nevojshëm. Pastaj kemi kuptuar se i njëjti zyrtar është dërguar në trajnime shtesë dhe si masë ndëshkuese ka qenë transferimi i tij në një përgjegjësi tjetër. Ndërsa, në fund të vitit 2012, i njëjti është shpallur punëtori më i mirë për vitin 2012.

Ky trajtim i tillë është paradoksal. A keni shpjegim shtesë për këtë rast z. kryeshef?

Fitim Shishani, kryeshef i IPK-së- Për rastin në fjalë, ne si IPK kemi deklaruar që është zbatuar ligji dhe ka qenë e nevojshme, pasi që zyrtari i Policisë së Kosovës kishte kërkuar

ndihmë. Pjesëtarët e IPK-së kanë autorizime policore, dhe në raste të caktuara, me ligj janë të obliguar të ofrojnë ndihmë.

Ndërsa sa i përket pyetjes nga z. Quni, se pse është vërë trajnimi shtesë, me këtë kemi dashur t'u tregojmë punonjësve dhe menaxhmentit të IPK-së që detyrat konkrete janë të tilla. Zyrtari i IPK-së, ka pasur detyrë vëzhgimin dhe ne e kemi vlerësuar të nevojshëm trajnimin.

Ne si IPK, nuk jemi pajtuar me vendndodhjen e zyrtarit të IPK-së në momentin e zhvillimit të protestës, pasi vëzhgimi bëhet në distancë më të largët. Dërgim i tij në trajnim shtesë, nuk ka qenë masë ndëshkuese, pasi menaxhmenti i IPK-së ka të drejtën e transferimit të zyrtarëve, sipas nevojës së institucionit.

Sa i përket asaj që është zgjedhur punëtori më i mirë, kjo ka qenë ide brenda organizatës, por zyrtari në fjalë nuk është zgjedhur punëtori më i mirë për virin 2012 nga menaxhmenti, por kolegët.

Anton Quni- Është e kuptueshme dhe njerëzore që në rastet kur kërkohet ndihmë nga një zyrtar policor, ofrohet ndihmë. Por, konsideroj se nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja nga ana e juaj për shtensionimin e situatës, njëherë viktimizimi i tij, e më pas rehabilitimi pasi një veprim i tillë nuk është shembull i mirë për organizatën.

Fitim Shishani- Për këtë çështje kam deklaruar se ka qenë i nevojshëm intervenimi dhe se kjo çështje i përket organizimit të brendshëm të IPK-së. Kjo nuk ka të bëjë me zbatueshmërinë e Ligjit të IPK-së. Qëllimi ka qenë që të tregohet se nëse caktohesh për vazhdim, duhet ta kryesh atë funksion dhe kjo është arsyeja që është dërguar në trajnim shtesë.

Ganimete Musliu- Për mënyrën e drejtimit të ankesave nga qytetarët dhe menaxhimit të tyre nga IPK-ja, bëri pyetjen si vijon:

Si njoftohet qytetari, që kërkesa e bërë nga formulari online në faqen e IPK-së, është pranuar apo s'është marrë në shqyrtim fare? A merr qytetari përgjigjeje nga IPK-ja, pasi që ta ketë bërë një ankesë, apo qytetari mbetet në pritje të një përgjigjeje?

Valbona Osmani- Iu përgjigj pyetjes së znj.Musliu. Tha se ne, posa të marrim një ankesë të tillë, menjëherë thërrasim qytetarin, ndërsa në rastet kur ankuesi dëshiron të mbetet anonim në ankesën e tij, nuk mund të kontaktohet, por merren në konsideratë.

Ganimete Musliu- Pyetjen e bëra, sepse edhe unë kam bërë një ankesë të tillë, me rastin e një sjellje jozyrtare të një patrulle të policisë, ndërkohë që po udhëtonim në një udhëtim zyrtar dhe se për këtë rast nuk kam marrë përgjigjeje nga IPK-ja.

Gjithashtu, këtë çështje e kam ngritur edhe në Komision dhe më është referuar ta paraqesë ankesën në IPK, për të cilën nuk kam marrë përgjigje. Nëse si deputete dhe si

anëtare e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, nuk marr përgjigje, atëherë si mund të jetë përgjigja ndaj qytetarëve të Kosovës.

Rexhep Selimi- Konsideroi se në takimin e kaluar mes grupit punues dhe IPK-së, ka qenë e nevojshme prezenca e kryeshefit të IPK-së, z. Shishani.

Në kuadër të mbikëqyrjes dhe takimeve, kemi veçuar çështjen e transferim të stafit që punon në IPK dhe që është transferuar nga Policia e Kosovës.

A kanë të kryer të gjithë të transferuarit nivelin universitar të shkollimit në përputhje me përgjegjësitë që mbajnë? Nga personat që janë transferuar nga Policia e Kosovës në IPK, sa prej tyre nuk kanë shkollim universitar?

Gjithashtu për të transferuarit, ju si IPK keni pasur të drejtë që për gjashtë muaj dhe gjashtë muaj shtesë, t'i keni në detyrë.

Ndërsa, kjo kohë ka kaluar. Mbi çfarë baze ligjore vazhdojnë të mbesin në punë zyrtarët e transferuar në IPK?

Për këtë çështje ne kemi marrë përgjigje se ekziston një marrëveshje në mes të kryeshefit të IPK-së dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. A ka bazë ligjore kjo marrëveshje?

Gjithashtu, çështje për të cilën mund të marrim përgjigje është rasti i vjedhjes së arit në Dhomën e Dëshmimeve të Policisë së Kosovës në Pejë, në rast se keni përgjigje për këtë, mund të na thoni?

Çështje tjetër që lidhet me transparencën e IPK-së, është se në faqen zyrtare është vetëm një raport për dy vite, si shpjegohet kjo çështje?

Fitim Shishani- Në përgjigje të pyetjes së znj. Musliu, them se ankesa e tillë duhet të jetë trajtuar, por nuk kanë ekzistuar elemente të veprës penale, megjithatë IPK-ja është dashur që t'ju njoftojë dhe për këtë të kërkojë falje.

Ndërsa, në përgjigjeje të pyetjes së z. Selimi, dihet se në çfarë kushtesh ka qenë IPK-ja dhe çfarë mandati ka marrë. Autorizime të mëdha, ndërsa në anën tjetër mungonte profesionalizmi për zbatimin Ligjit të IPK-së, pas marrjes së kompetencave për hetimin e veprave penale.

Për këtë arsye i kam propozuar drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës që IPK-ja të merr 15 persona nga policia, por duke dhënë dorëheqje të parevokueshme, në momentin që do të kalonin në IPK.

Marrëveshja është mes drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe kryeshefit të IPK-së, kërkesë të cilën e ka mbështetur edhe ministri i MPB-së.

Ndërsa, sa i përket kualifikimeve, them se personat që kanë atributet dhe janë të përshtatshëm për Policinë e Kosovës të punojnë në hetime, në Departamentin e Krimeve të Rënda, pse mos të jenë të përshtatshëm të punojnë për IPK-në, pasi përvoja është shumë e rëndësishme. Prandaj, përvoja në fushën e hetimeve i shërben punës së IPK-së.

Ndërsa sa i përket transferim 6+ 6, kjo është një segment relativ, pasi për një zyrtar i cili në polici ka përvojë pune dhjetëvjeçare, ndërsa në IPK të kalonte në punë provuese, kjo nuk do të ishte mirë. Vlerësoj se periudha vlerësuese, 6+6 do të ishte adekuate për pjesëtarët të cilët aktualisht trajnohen në Vushtrri, të cilët gjashtë muaj i përfundojnë në Vushtrri, ndërsa gjashtë muaj të tjerë në IPK.

Rexhep Selimi- Nuk është tendenca që zyrtarët e transferuar të përjashtohen, pasi në periudhën 6+6, zyrtarët e transferuar do të duheshin që të certifikoheshin në punën e vet.

Ne nuk i paragjykojmë aftësitë e hetuesve, personelit të Inspektoratit, por këta zyrtarë do të duheshin që t'i plotësonin kriteret që të jenë me nivel universitar, dhe për këtë çështje, ne duam përgjigje dhe sa është numri i tyre që kanë dhe nuk kanë përgatitje universitare. Pasi ajo çfarë na intereson është zbatueshmëria e Ligjit nga IPK-ja. Sa është e ligjshme marrëveshja mes kryeshefit të IPK-së dhe drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për çështjen e transferimeve dhe a ka bazë ligjore kjo marrëveshje?

Fitim Shishani- Sa i përket certifikimit të zyrtarëve të IPK-së, ata janë certifikuar në Policinë e Kosovës, ndërsa sa i përket aspektit universitar, në rastin konkret fjala është për transferim dhe në këtë rast vetëm është bërë transferimi, por jo rekrutimi.

Rexhep Selimi- A mund të më japësh një numër, sa janë pa fakultet?

Fitim Shishani- Për t'u përgjigjur në këtë pyetje fjalën ia dha z. Arsim Telaku, drejtor i Administratës në IPK.

Arsim Telaku- Në përgjigje të pyetjes së z. Selimi tha se, edhe pse kësaj pyetjeje i jemi përgjigjur disa herë, prapë e them se janë tre zyrtarë që kanë përgatitje shkollore të arsimit të mesëm dhe dy nga ta janë nga komuniteti serb.

Sa i përket procedurave të transferimit, fillimisht i kanë paraqitur kërkesat personelit, ata të cilët kanë dashur të transferohen në IPK.

Fatmir Xhelili- Ligji i ri i IPK-së, përcakton kompetenca të reja për stafin IPK-së, në bazë të cilit zyrtarët marrin edhe kompetenca në hetuesi. Ligjet si ai për IPK-në, Policia e Kosovës, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, kanë pësuar plotësim-ndryshime. Gjatë zbatimit të Ligjit të IPK-së, a keni hasur në ndonjë nen në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale apo Ligjit të Policisë, që ka qenë pengesë për ushtrimin e detyrave të zyrtarëve të IPK-së?

A keni ndërmarrë masa për të bërë ndonjë inspektim për ndryshimin e parimeve dhe procedurave të policisë, në mënyrë që ato të jenë sa më efektive, në mënyrë që qytetarët të kenë më të lehtë komunikimin me policinë?

A keni bërë ndonjë inspektim për qarkullimin e informacionit brenda policisë, pasi mund të ndodh që disa zyrtarë të mos jenë të kujdesshëm për informacionet që posedojnë?

Fitim Shishani- Në zbatimin e Ligjit të IPK-së, nuk kemi ndonjë pengesë të madhe të dispozitave të Ligjit të IPK-së që do ta pengonin IPK-në në realizimin detyrave të saj.

Ndërsa sa i përket inspektimeve, e pranojmë se jemi vonuar me disa obligime të disa raporteve inspektuese, por do t'i japim arsyet.

Kemi formuar departamentin e veçantë për analizimin e informacionit dhe ankesave, ndërsa sa i përket reagimeve të IPK-së në raport me qarkullimin e informacioneve brenda policisë, me sa kam informacione, vetë policia i ka bërë disa strategji për këtë çështje. Nga IPK-ja, nuk është ndërmarrë veprim i tillë se sa informacione mund të kenë ikur nga policia, por mendoj se policia e ka një strategji për këtë qëllim.

Ganimete Musliu- Në bazë të informatave që posedoj, një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës, duke përdorur kartën e kolegjalitetit, bëjnë shkelje duke vozitur automjetet e tyre të paregjistruara. Për këtë çështje desha të marrë opinion nga drejtori i Përgjithshëm i Policisë dhe nga kryeshefi i IPK-së.

A keni informacione që anëtarët e policisë bëjnë një shkelje të tillë në komunikacion dhe nëse po, cilat janë masat që do të ndërmerren?

Shpend Maxhuni- Kemi pasur informacione për shkelje të tilla dhe kurdoherë që kemi pasur informacion dhe janë kapur në flagrancë, janë ndërmarrë veprimet ligjore, por raste të tilla nuk janë në numër të madh.

Ganimete Musliu- E konsideroj si pozitive identifikimin e këtyre rasteve dhe do të kërkoja nga ju dhe IPK-ja që të shtohet kontrolli ndaj kësaj çështjeje.

Danush Ademi- Pyetje për z. Shpend Maxhuni. Rasti i një zyrtari policor nga Ferizaj, i cili ka vuajtur dënimin prej 12 muajve në paraburgim, ndërsa në fund Gjykata e ka shpallur të pafajshëm, a ka të drejtë ky zyrtar të kthehet në punë, dhe nëse po, pse nuk është kthyer deri tani?

Shpend Maxhuni- Kur konstatojmë se një zyrtar policor mund të jetë i përfshirë në një vepër penale, bashkë me IPK-në dhe prokurorinë kompetente, iniciojmë procedura ligjore, dhe nëse në fund të procedurës nuk gjendet fajtori, askujt nuk i mohohet e drejta për të qenë pjesë e Policisë së Kosovës.

Danush Ademi- Zyrtari në fjalë është z. Ukshin Rrahmani nga Ferizaj, i cili për nëntë vite ka qenë pjesëtar i Policisë së Kosovës, dhe për çfarë arsye deri tani më nuk është kthyer dhe a ka ndonjë limit se deri kur mund të kthehet në vendin e punës?

Shpend Maxhuni- Limitet janë të përcaktuara me ligj dhe me udhëzime administrative, por për rastin konkret do të interesohem personalisht.

Goran Marinković- Sipas Ligjit të IPK-së, nenit 16, IPK-ja ka një staf i cili është i ndarë në disa kategori, si hetuesi, inspektime dhe stafi mbështetës dhe stafi i punësuar me kohë të pjesshme.

Si dhe sa përmbushën normat nga ana e IPK-së për punësimin e komunitetit serb? Sa është numri i të punësuarve nga komuniteti serb në IPK?

Fitim Shishani- Në IPK janë të punësuar nga të gjitha nacionalitetet që jetojnë në Kosovë, përfshirë edhe nga komuniteti serb. Aktualisht, i punësuar është vetëm një serb, ndërsa një zyrtar tjetër e ka lëshuar vendin e punës, ndërsa në javët e ardhshme do të transferohen dy zyrtarë policorë serbë në IPK.

Rasim Demiri- Pyetje për z. Maxhuni në lidhje me pikën kufitare në Komunën e Dragashit, Restelicës dhe Krushevës. Qytetarët që jetojnë në këto zona ballafaqohen me vjedhje të pronës nga persona që vijnë nga kufiri tjetër. A është në dijeni policia me këto raste dhe a ka ndërmarrë masa?

Shpend Maxhuni- Për të gjitha incidentet që kanë ndodhur janë ndërmarrë masat dhe janë ushtruar kallëzime penale dhe tani rastet janë në procedurë gjyqësore. Ne e kemi sugjeruar policinë kufitare që të jenë prezent në zonat ku jetojnë komunitetet dhe kemi bashkëpunim të mirë me Policinë e Shqipërisë, ku realizohen patrullime kufitare të sinkronizuara.

Ndërsa sa i përket përgatitjeve për aktivizimin e pikës së përkohshme, jemi në procedurë e sipër dhe do të jetë një qasje e vazhdueshme e policisë, e cila do të jetë nën patronatin e Policisë së Kosovës.

Anton Quni- Pyetje për z. Shishani. Largimi i disa zyrtarëve nga IPK-ja, të cilët krahas arsimit universitar kanë pasur edhe përvojën, është bërë për shkak të menaxhimit nga ana e juaj, duke i dhënë përparësi përvojës e jo shkollimit.

Për rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmive në Pejë, është arrestuar një zyrtar policor, dhe nga ana juaj, me plot bindje, keni deklaruar se keni fakte duke marrë për bazë materialin e konfiskuar.

Ndërsa i njëjti zyrtar tani vazhdon punën në Policinë e Kosovës dhe konsideroj se deklarata e juaj ka dëmtuar atë dhe imazhin policisë.

A mendoni se me deklaratat e juaja keni dëmtuar imazhin e tij, dhe pas heqjes së akuzave ndaj tij, nuk është dhënë asnjë shpjegim nga IPK-ja në lidhje me rastin?

Fitim Shishani- Sa është numri i atyre zyrtarëve që konsideroni se është i madh dhe mund të jenë larguar nga menaxhmenti i IPK-së z. Quni?

Anton Quni- Numrin 4-5 zyrtarë të larguar është i konsiderueshëm.

Fitim Shishani- Nuk është numri që thoni dhe e them me përgjegjësi që asnjë zyrtar i IPK-së nuk është larguar me tendencë, secili ka bërë zgjedhjen e vet për t'u larguar ose vazhduar, ndërsa rastet të cilat janë konsideruar shkelje, janë publikuar nga IPK-ja.

Sa i përket paraqitjes mediale në rastin e zyrtarit policor të përfshirë në rastin e vjedhjes në Dhomën e Dëshmive në Pejë, për këtë rast kemi qenë transparent dhe për këtë rast e kam njoftuar edhe z. Ahmet Isufi, më datë 15.06.2012.

Ne si IPK, kemi zbatuar ligjet në fuqi, Kodin e Procedurës Penale, Kodin Penal dhe Ligjin e IPK-së. Gjithashtu, jemi konsultuar me prokurorin e Republikës së Kosovës për çdo veprim të ndërmarrë nga IPK-ja.

Vendimet merren nga gjykatat dhe ne si IPK nuk i komentojmë këto vendime, prandaj si kryeshef nuk i komentoj vendimet Prokurorisë e as të Gjykatës.

Anton Quni- Për rastin në fjalë, ju keni dalë në deklaratë për media duke dalë jashtë kompetencave tuaja, duke ndërhyrë në kompetencat e gjykatësit dhe prokurorit. Prandaj, konsideroj se për këtë rast jeni ngutur shumë në arrestimin e zyrtarit policor, duke mos e lënë që me këtë rast të merret prokurori dhe organet e drejtësisë, por paraprakisht e keni shpallur fajtor.

Fitim Shishani- Ne kemi dalë me deklaratë si IPK, për hir të transparencës, bashkërisht me policinë, duke vepruar sipas ligjit. Kemi ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale, të cilat janë lidhur me urdhëresën Prokurorisë. Ndërsa sa i përket se e kam shpallur fajtor, për këtë çështje kompetente është gjykata.

Florian Qehaja, drejtor i QKSS- Nga diskursi i zhvilluar, lë të kuptohet se IPK-ja është e politizuar, por për mendimin tim ky institucion duhet të depolitizohet, pasi arsye e themelimit të këtij institucioni i jep atij një mandat special, jo policor dhe në përputhje me kontrollin civil demokratik të institucioneve të sigurisë.

Argumenti se duhet t'u jepet përparësi zyrtarëve policorë, nuk vlen, sepse dihet se IPK-ja merret edhe me hetime.

U theksua se IPK-ja ka mungesë të profesionalizmit dhe për këtë e kanë mbështetur organizata të huaja, siç është ICITAP-i. Dilema në këtë rast është se çfarë do të ndodh kur nuk do të përkrahen nga këto organizata, a ka ndonjë plan për ofrimin e trajnimeve nga ana e IPK-së dhe si do të ngrihen kapacitetet me shkuarjen e këtyre organizatave?

Konsideroj se Komisioni që mbikëqyrë IPK-në duhet të bëjë vlerësimin e parimeve se deri në çfarë mase parimet e përcaktuara me ligj janë duke u respektuar, sa është i depolitizuar, i paanshëm. E rëndësishme është të vlerësohet se deri në çfarë mase janë bërë hetime nga ana e IPK-së.

Fitim Shishani- Iu përgjigj pyetje së z. Qehaja dhe tha se diskursi policor sa i përket IPK-së, është i pashmangshëm, pasi disa vende të rajonit kanë praktika që marrin pjesëtarë nga policia dhe i përfshijnë në këtë institucion, pasi ata njohin më mirë fushën. Aktualisht, kemi pesëmbëdhjetë zyrtarë që janë në trajnim në Vushttri, të cilët janë qytetarë të thjeshtë.

Ndërsa sa i preket ngritjes së kapaciteteve profesionale pas shkuarjes së organizatave që e mbështesin punën e IPK-së, siç është ICITAP, OSBE, EULEX, ne trajnojmë kuadro që të jenë të përgatitur që pas shkuarjes së tyre, të kemi mundësi për trajnime.

Ndërsa sa i përket pjesës së hetimeve, IPK-ja bën aq sa i lejon ligji në këtë aspekt.

Rexhep Selimi- Pyetje për drejtorin e Policisë, z. Maxhuni:

A keni marrë rekomandime nga IPK-ja dhe cili është rekomandimi për masat e ndërmarra ndaj pjesëtarëve të policisë që kanë marrë pjesë në arrestimin e truprojave të Aleksandër Vulin?

A janë ndërmarrë masa të njëjta edhe ndaj zyrtarëve policorë të cilët kanë përdorur forcën gjatë zhvillimit të disa protestave në Prishtinë?

Ndërsa sa i përket transparencës së IPK-së që e përmendi z. Shishani, them që ky parim nuk është realizuar sa duhet, pasi raporti i juaj nuk është publikuar në faqen e internetit, të cilin mund ta shihnin të gjithë qytetarët.

A vazhdojnë hetimet për zyrtarin policor, i cili dyshohet se ka qenë i përfshirë në rastin e vjedhjes së arit në Dhomën e Dëshmive në Pejë?

Fitim Shishani- Sa i përket rastit të zyrtarit policor të dyshuar për vjedhjen e arit në Dhomën e Dëshmive në Pejë, IPK-ja vepron sipas ligjit dhe nuk jemi ne që e dimë nëse vazhdojnë apo jo hetimet. Nuk japim sqarime e as konstatime për rastet që janë në proces e sipër, por ky rast është ende i hapur. Ndërsa, sa i përket transparencës së IPK-së, ne jemi bashkëpunues, ndërsa konsideroj se jemi vonuar në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të IPK-së.

Shpend Maxhuni- Kurdoherë që prokuroritë kompetente vendore apo të EULEX-it, përfshirë edhe IPK-në si institucion që ka mandat hetimin e policisë, vlerësohet se në bazë të nevojës ndërmerren veprime të përkohshme ndaj një zyrtari, këto rekomandime merren parasysh dhe trajtohen.

Ndërsa në rastin e përdorimit të forcës nga ana e zyrtarëve policorë në rastin e arrestimit të z. Vulin, IPK-ja ka rekomanduar mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë për suspendimin me pagesë të zyrtarëve policorë dhe rasti është në vazhdim.

Rexhep Selimi- Në rastin e përdorimit të forcës nga zyrtarët policorë, me rastin e demonstratave, a ka pasur rekomandime dhe cilat janë masat që janë ndërmarrë ndaj tyre?

Shpend Maxhuni- Nga rekomandimet që marrim nga IPK-ja, merremi me rastet si në aspektin hetimor edhe në aspektin etik e profesional dhe më pas ndërmarrjen e masave, si suspendimin e përkohshëm ose transferimin e përkohshëm.

Fitim Shishani- Theksoj që për masa disiplinore IPK-ja nuk jep rekomandime, përveç rangut të lartë.

Rexhep Selimi- A është vepër penale rasti i arrestimit të truprojave të Vulinit, përdorimi i forcës nga ana e zyrtarëve policorë në këtë rast?

Fitim Shishani- Për vepra penale IPK-ja rekomandon suspendim ose transferim, ndërsa masat disiplinore në rastin e zhvillimit të protestave në Prishtinë, dhuna e ushtruar ndaj protestuesve, ka qenë e tepruar, por jo vepër penale. Në raste të tilla, rekomandimi dërgohet në polici dhe nga ana e tyre ndërmerret masa.

Rexhep Selimi- A mund të na thoni se në cilin rast ka qenë më i madh përdorimi i forcës nga ana e zyrtarëve policorë, gjatë arrestimit të truprojave të z. Vulin apo gjatë protestave në sheshin kryesor në Prishtinë?

Fitim Shishani- Nuk mund të krahasohen këto dy raste, pasi nuk kemi bërë hetime për të dy çështjet, por kemi bërë hetimin vetëm për njërin rast.

Izmi Zeka, zëvendësministër i MPB-së- Policia e Kosovës funksionon në bazë të Ligjit për Policinë e Kosovës dhe ka një hierarki të organizuar. Me gjithë sfidat që mund t'i kenë, Policia e Kosovës dhe IPK-ja janë institucione të Kosovës dhe funksionojnë në bazë të ligjeve.

Fitim Shishani- Falënderoi anëtarët e Komisionit për bashkëpunimin dhe kërkoi që të realizohen kërkesat që janë bërë nga ana e tyre në aspektin buxhetor, duke kërkuar mbështetje të vazhdueshme, e cila do ta ndihmonte zbatueshmërinë e ligjit.

Kryetari i Komisionit- Falënderoi përfaqësuesit e IPK-së për prezencën në takim dhe shtoi se grupi punues do të dalë me raportin përfundimtar me rekomandime, i cili do të shqyrtohet në seancë plenare.

Gjithashtu, theksoi se IPK-ja dhe Policia e Kosovës duhet të punojë me një standard, duke i trajtuar njëllë të gjithë qytetarët e Kosovës dhe si Komision parlamentar jemi të obliguar të mbikëqyrim punë e këtyre institucioneve dhe me këtë e konsideroi të mbyllur takimin, duke i falënderuar të gjithë të pranishmit për kontributin në këtë dëgjim publik.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ahmet Isufi